



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 02 datë 23.07.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR RIKONSTRUKSION PA NDRYSHIM
FUNKSIONI PËR OBJEKTIN: “RIKONSTRUKSION GODINE TË
MATERNITETIT (OBSTETRIK, GJINEKOLOGJI, NEONATOLOGJI, ORL-OKL
DHE DERMATOLOGJI)” ME VENDNDODHJE NË BASHKINË SHKODËR

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Drejtorisë së Spitaleve Shkodër, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të lejes së ndërtimit për rikonstrukcionin pa ndryshim funksioni për objektin: “Rikonstrukcion Godine të Maternitetit (Obstetrik, Gjinekologjik, Neonatologji, Orl-Okk dhe Dermatologji)”, me vendndodhje në Bashkinë Shkodër, me zhvillues Drejtorinë e Spitaleve Shkodër.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuarës vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Shkodër.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE


EVIS SALA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADEL AJDAROKA



Nënshkruar më datë 26/11 / 2025